



Datë: 17.11.2025
Numër Protokolli: 7506/2025

A.nr.1275/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1275/2025, të datës 02.07.2025, të parashtruar nga ankuesja M.D-K, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 17.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1275/2025, e datës 02.07.2025, e parashtruar nga ankuesja M.D-K.
- II. Anulohet** në tërësi procedura e pranimit me numër reference RN00017882, pozita Zyrtar për Arkiv, në Departamentin për Shërbime Administrative, i shpallur me datë 22.05.2025, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- III. Obligohet** Udhëheqësi/ja i/e Njesisë së Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që brenda aftit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohen në pikën II të dispozitivit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, M.D-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 02.07.2025, përmes adresës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit me numër reference RN00017882, pozita Zyrtar për Arkiv, në Departamentin për Shërbime Administrative, i shpallur me datë 22.05.2025, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë provat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4474/2025, të datës 02.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuese; Formularin e Parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.07.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit të datës 29.07.2025; Konkursin me numër reference RN00017882; Njoftimin Nr.2030, të datës 04.06.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin Nr.1990, të datës 03.06.2025; Akt emërimit të datës 12.11.2018; Vendimin Ref.353/25, të datës 29.05.2025; Vendimin e datës 31.05.2024; Vendimin e datës 09.06.2025; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 30.04.2025; Njoftimin për intervistë me gojë të datës 05.06.2025; Formularët e intervistës me gojë të datës 10.06.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 30.05.2025, të kandidatës M.D-K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 29.05.2025, të kandidatës F.Sh së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Renditjen përfundimtare nga SIMBNJ të datës 10.06.2025; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 11.06.2025; Vendimin me numër protokolli 5504/2025, të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave materiale të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 22.05.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017882, për Grupin e Shkencave Shoqërore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar për Arkiv, në Departamentin për Shërbime Administrative, për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme, me klasë të pozitës Profesional 2, për 1 (një) vend pune, i hapur për aplikim nga data 23.05.2025 deri më datën 30.05.2025. Tutje, sipas provave materiale të lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, e njehta e ka kaluar fazën e vlerësimit të verifikimit paraprak, ndërsa më datë 10.06.2025, i është nënshtruar intervistës me gojë mirëpo sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit ankuesja është renditur si kandidatja e dytë me më së shumti pikë të arritura, ndërsa, si kandidate me më së shumti pikë rrjedhë të jetë F.Sh me gjithsej 87.33 pikë, ashtu që edhe e njëjta është shpallur edhe kandidate fituese sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.2107, të datës 11.06.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00017882, për pozitën Zyrtar për Arkiv, mbi pretendimin ankimor se pasi që ka kërkuar qasje në dosjen e kandidatës fituese në organin përkatës të punësimit ka vrejtë se kandidatja fituese nuk e ka përvojën profesionale për pozitën e shpallur, shton se komisioni i pranimit ka vlerësuar CV, e kandidatës fituese me më shumë pikë, edhe pse sipas ankuses e njehta posedon përvojën adekuate për pozitën e shpallur. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të rishqyrtoj aplikacionin në mënyrë të drejtë.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një*

*fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00017882. Rrjedhimisht, në kontekst të këtij përcaktimi, e në kuptim të kriterëve formale të përgjithshme Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00017882, dhe si pasojë ka konstatuar së pozita *Zyrtar për Arkiv*, është shpallur në Grupin e Shkencave Shoqërore, klasa Profesional 2, ndërsa, si kriterë të përgjithshme formale janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi dhe Administratë Publike; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 1 (një) përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Si rrjedhojë e analizimit të aktit të shpalljes së konkursit të kontestuar, Kolegji erdhi në përfundimin së duke qenë së pozita e shpallur ka të bëjë me arkivë atëherë edhe njëta grupohet në grupin e arkivës, andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së organi i punësimit në këtë rast MPBZHR-ja me rastin e shpalljes së konkursit përkatës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil, mbi arsyet se, pozita zyrtar i arkives në Katalogun e Vendeve të Punës është e sistemuar me kodin SHC-1043, klasa Profesional 2, Grupi i arkiv- dokumentacionit, kurse, sipas Shtojca Nr. 2: [Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm], të Rregullores Nr.06/2024 si fusha të arsimit për grupin e Arkives janë përcaktuar: Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë/Antropologji/Ballkanistikë, ndërsa, MPBZHR-ja me rastin e shpalljes së konkursit të kontestuar, ka vendosur fusha të tjera të arsimit si rezultat i grupit jo të drejtë.

Andaj, mbi bazën e këtyre konstatimeve, e në kuptim të nenit 19 dhe nenit 31 par.2, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. *Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi.* 30.2. *Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.*”, Kolegji konstaton së MBPZHR-ja me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën *Zyrtar për Arkiv*, ka vepruar në kundërshtim me ligjin material, kështu që vendosja e kriterëve formale të konkursit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ka bërë që procedurat e kontestuar (si tërësi e veprime administrative) të kualifikohen si e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rrjedhimisht, duke qenë së akti e shpalljes së konkursit kontestuese është përfshirë me shkelje esenciale materiale, atëherë, çdo veprim tjetër procedural i ndërmarrë në këtë procedura është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike, kështu që, mbi këtë bazë të konstatimit, Kolegji nuk ka trajtuar ligjshmërinë e fazave tjera procedurale, të pasuara pas përmbylljes së konkurseve përkatëse.

Thënë si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00017882.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1275/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.D-K;
- Njesisë se Personelit në MPBZHR; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.